

Neni 153 [Prania Ndërkombëtare Ushtarake]

1. Prania Ndërkombëtare Ushtarake nën komandën e NATO-s, është përgjegjëse për të siguruar ambient të qetë e të sigurt në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka pushtet mbikëqyrës dhe ekzekutiv mbi Forcën e Sigurisë të Kosovës.
3. Republika e Kosovës, në bashkëpunim me autoritetet ndërkombëtare të themeluara për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të Propozimit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, do të përgatisë një plan, për transferimin e plotë dhe me kohë të përgjegjësi mbi sigurinë të institucionet kosovare.
4. Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka të drejtë të rivendosë kontrollin ushtarak mbi hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, dhe Autoriteti Civil i Aviacionit i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë plotësisht me Pranimë Ndërkombëtare Ushtarake.

Neni 154 [Trupat e Mbrojtjes të Kosovës]

Trupat e Mbrojtjes të Kosovës do të shpërbëhen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Deri në shpërbërje, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me pranimë ndërkombëtare civile dhe Republikën e Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi Trupat e Mbrojtjes të Kosovës dhe vendos për dinamikën kohore të shpërndarjes.

Neni 155 [Shtetësia]

1. Të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës ua njeh të drejtën për ta fituar nënshtetësinë e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe nënshtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës me datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë.

Neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vëndit]

Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vëndit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.